

L I G J
Nr.7502, datë 25.7.1991

PËR PARTITË POLITIKE

Ne mbështetje të neneve 6 dhe 16 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve politike të përbashkëta, që synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqesimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Neni 2

Partitë politike marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në të gjitha fushat e jetës publike e kryesisht :

- a) nëpërmjet ndikimit në krijimin e opinionit publik dhe të edukatës politike;
- b) nëpërmjet nxitjes së pjesëmarrjes aktive të shtetasve në jetën politike dhe evidentimit e aftësimit të njerëzve për të marrë përsipër përgjegjësi publike;
- c) nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet kombëtare e lokale.

Neni 3

Partitë politike janë pjesë integrale kushtetuese të një sistemi të lirë e demokratik qeverimi. Veprimtaria e tyre është e lirë dhe e grantuar me ligjin " Për dispozitat kryesore kushtetuese".

Neni 4

Partitë politike përdorin vetëm mjete dhe metoda demokratike për arritjen e qëllimeve të tyre.

Neni 5

Veprimtaria e partive mund të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose në disa rrethe.

Neni 6

Nuk lejohet krijimi i një partie ose ndalohet veprimtaria e saj :

- a) kur qëllimet e saj propogandon ose përpiqet t'i realizojë me përdorimin e dhunës, forcës së armëve e të çdo mjeti tjetër antidemokratik e luftënxitës ;
- b) kur qëllimet e veprimtaria e saj kanë karakter racist, totalitarist, shovinist, antikombëtar, nxitin urrejtjen kombëtare;
- c) kur qëllimet e veprimtaria e saj vijnë në kundërshtim me parimet kushtetuese të shtetit ligjor, demokratik e social, me sovranitetin e popullit, me pluralizmin dhe barazinë e partive, me parimin e ndarjes së pushteteve dhe pavarësinë e gjykatave;

ç) kur organizimi i saj i brendshëm është në kundërshtim me parimet demokratike si: ndërtimi nga poshtë lartë i partisë, zgjedhjet e brendshme demokratike për forumët e partisë, e drejta e shprehjes së mendimit për çdo anëtar, liri hyrje e dalje nga partia, deklarim dhe lejim i kontrollit në përdorimin e burimeve dhe mjeteve financiare;

d) kur krijon pranë saj organizata të fshehta ose me karakter ushtarak;

Nuk lejohet formimi i partive mbi baza fetare, etnike dhe krahinore.

Nuk njihet asnjë parti politike që formohet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Emri i një partie duhet të jetë i dallueshëm qartë nga ai i partive të tjera ekzistuese. Inicialët dhe emblema e tyre nuk duhet të përputhen.

Gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe në zgjedhjen përdoren vetëm emrat e regjistruar ose inicialet.

KREU II FORMIMI I PARTIVE POLITIKE

Neni 8

Shtetasit që dëshirojnë të formojnë parti politike detyrohen të drejtojnë kërkesë Ministrisë së Drejtësisë, duke paraqitur dokumentat përkatëse (programin dhe statusin ose rregulloren e partisë).

Neni 9

Në dokumentet për njohjen e partisë politike përcaktohet:

a) emertimi dhe qendra e partisë;

b) qëllimet dhe detyrat e saj;

c) organet udhëheqëse e ndërtimi i partisë;

ç) burimet e financimit.

Neni 10

Kërkesa për formimin e një partie politike duhet të nënshkruhet të paktën nga 300 vetë.

Neni 11

Ministria e Drejtësisë duhet të shpallë miratimin ose refuzimin e kërkesës së formimit të partisë brenda 45 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të saj. Afati fillon nga çasti kur dokumentet janë paraqitur sipas rregullave të këtij ligji.

Kur Ministria e Drejtësisë verën se nuk janë zbatuar rregullat e caktuara në këtë ligj, brenda 20 ditëve e kthen kërkesën për plotësimet përkatëse.

Efektet e kësaj dispozite kanë fuqi prapavepruese.

Neni 12

Kur Partitë politike të njohura bëjnë ndryshime të rëndësishme në program, statut ose në emertimin e tyre, vënë në dijeni Ministrin e Drejtësisë për të kryer veprimet përkatëse.

Kur Ministria e Drejtësisë verën se këto ndryshime vijnë në kundërshtim me rregullat e këtij ligji, vendos mospranimin e tyre dhe brenda 20 ditëve nga paraqitja e kërkesës, njofton organin e interesuar.

Neni 13

Kundër aktit të Ministrisë së Drejtësisë, që refuzon kërkesën për formimin e një partie, që

ndalon vazhdimin e veprimtarisë së saj ose që nuk pranon kërkesën për ndryshime në program, statut dhe në emertimin e partisë, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve nga dita e njoftimit, në Gjykatën e Lartë, e cila brenda 15 ditëve merr vendim të formës së prerë.

Neni 14

Shtetasit e huaj që nuk kanë banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë nuk mund të marrin pjesë në formimin e një partie dhe as të jenë anëtarë të saj.

Neni 15

Partitë politike nuk mund të krijojnë organizata të rinisë jashtë tyre ose të fëmijëve.

Neni 16

Organizatat që nuk janë rregjistruar si parti politike nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.

Partitë politike nuk mund të kryejnë veprimtarinë e tyre pa u regjistruar.

KREU III

MJETET FINANCIARE DHE MATERIALE TË PARTIVE POLITIKE

Neni 17

Partitë politike janë person juridik. Ato kanë pasuri për kryerjen e veprimtarisë së tyre.

Partitë politike kanë shtypin, mjetet e tyre të propogandës si dhe institucionet përkatëse realizuese.

Neni 18

Burimet financiare dhe materiale të partive politike përbëhen nga:

1. kuotat e anëtarësisë;
2. çdo pasuri e fituar në mënyrë të ligjshme;
3. të ardhurat nga veprimtaria ekonomike e socialkulturore;
4. ndihma financiare në masën e caktuar në buxhetin e shtetit, të miratuar me ligj nga Kuvendi Popullor.

Neni 19

Shteti ndihmon githashtu materialisht Partitë politike në kohën e krijimit të tyre.

Neni 20

Për Partitë politike të sapo krijuar, masa e ndihmës financiare e materiale fillestare shtetërore përcaktohet nga Këshilli i Ministrave mbi bazën e numrit të anëtarëve dhe shtrirjes territoriale të partive.

Ndihma financiare janë jo më shumë se 2 Për qind e buxhetit vjetor të caktuar për financimin e partive.

Neni 21

Në buxhetin shtetëror vjetor parashikohen ndihma financiare për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

Dhjetë për qind e këtyre ndihmave ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet partive politike, që kanë jo më pak se 5 000 anëtarë.

Pjesa tjetër ndahet në përpjestim me numrin e votave të marra në zgjedhjet e fundit. Nga kjo shpërndarje nuk përfitojnë ato parti që kanë marrë më pak se 2 përqind të votave.

Neni 22

Për çdo fushatë elektorale kombëtare ose lokale jepen ndihma financiare të veçanta nga buxheti i shtetit, sipas kritereve të caktuara në ligjet elektorale.

Neni 23

Ndalohen ndihmat financiare dhe materiale nga shtetet dhe entet publike a private të huaja.
Lejohen dhuratat dhe ndihmat kur vijnë nga parti a bashkime ndërkombëtare partish, deri në masën që nuk kalon ndihmën financiare të dhënë nga shteti.

Neni 24

Ndalohen ndihmat financiare dhe materiale për Partitë politike nga entet publike të vendit, si dhe nga entet me pjesëmarrjen e kapitalit shtetëror.

Neni 25

Shteti lehtëson veprimtarinë e partive. Për këtë:
1. Partitë kanë të drejtë të përdorin pa shpërblim mjetet e informimit masiv publik.
2. Veprimtaritë ekonomike që lidhen ngushtë me realizimin e qëllimeve të partisë siç janë botimet për nevojat e brendshme të saj, përjashtohen nga tatimi.
Përjashtohen nga këto lehtësi veprimtaritë ekonomike që kryhen vetëm për qëllim fitimi.

Neni 26

Në fund të vitit kalendarik, Partitë paraqesin raportin e veprimtarisë së tyre ekonomiko-financiare, i cili shqyrtohet nga një komision ekspertesh i ngritur për këtë qëllim nga Kuvendi Popullor. Ky komision ka të drejtë të kontrollojë të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të partive.

Raporti përfundimtar i këtij komisioni i paraqitet Kuvendit Popullor.

KREU IV MBARIMI I PARTIVE POLITIKE

Neni 27

Partia politike mbaron në këto raste:

1. Kur shkrihet ose bashkohet me parti të tjera;
 2. Kur ndahet në dy a më shumë parti të tjera;
 3. Kur vetëshperndahet në përputhje me normat e statutit të saj.
 4. Kur ndalohet veprimtaria e saj me vendim të organit kompetent.
- Vendimi për mbarimin e partisë rregjistrohet në Ministrinë e Drejtësisë.

KREU V ORGANIZATAT DHE SHOQATAT

Neni 28

Për organizatat dhe shoqatat, të cilat marrin pjesë në formimin e vullnetit politik të popullit në fusha të veçanta të jetës publike dhe që janë përcaktuar si të tilla në statutet e tyre, zbatohen nenet 4,5,6 (paragrafi I dhe III) ,7 (paragrafi I),8 deri 15, 16 (paragrafi II),17, 18 (pika 1,2 e 3) 23 deri 25

dhe 27 të këtij ligji.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 29

Punonjësit e aparateve të partive politike përfitojnë të gjitha të drejtat që kanë punonjësit e tjerë sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore shtetërore", si dhe ndryshimet në masën e shpërblimit që vijnë si rrjedhim i reformës ekonomike.

Neni 30

Dekreti nr.7442, datë 17.12.1990 " Për krijimin e organizatave dhe shoqatave politike ", shfuqizohet.

Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
RAMIZ ALIA